



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGI
ENERGY REGULATORY OFFICE
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU

Rishikimi i Rregullave për Tarifa të Energjisë Elektrike

Dokumenti Sqarues

1 gusht 2011

Përmbajtja

Definicionet	3
1 Hyrje.....	5
2 Rregullat për Tarifa.....	5
3 Rregulla e Çmimeve të OST-së.....	6
3.1 Mënyra e rregullimit të çmimit	6
3.2 Përcaktimi i të Hyrave të Lejuara fillestare	6
3.2.1 Qasja	6
3.2.2 Përcaktimi i Bazës së Rregulluar të Aseteve (RAB)	7
3.3 Përshtatjet e Rregullta.....	8
3.4 Ngarkesat për shfrytëzim të sistemit dhe për kyçje në sistem	9
3.5 Procedurat	9
4 Rregulla e Çmimeve të OSSH-së	10
5 Rregulla e çmimeve të gjenerimit.....	10
6 Rregulla për çmimet e FPEE-së	11
6.1 Mënyra e rregullimit të çmimit	11
6.2 Përcaktimi i kostove të lejuara	12
6.2.1 Kostot direkte me pakicë	12
6.2.2 Kostoja e blerjes së energjisë me shumicë	12
6.2.3 Kostot që barten	13
6.2.4 Alokimi i kostove të lejuara.....	13
6.3 Të hyrat nga eksporti.....	13
6.4 Përshtatjet e rregullta	14
6.5 Tarifat e rregulluara me pakicë	15
6.6 Procedurat	15
Përcaktimi i kostove të lejuara.....	16
Shpenzimet operative	16
RAB-i fillestar	16

Table of Contents

Shpenzimet Kapitale	16
Zhvlerësimi.....	17
WACC-u.....	17
Kostot e lejuara.....	17
Konvertimi në të hyra të lejuara	18
Përshtatjet e Rregullta	19

Definicionet

Vit Relevant	Periudhat brenda Periudhës Rregullative brenda të cilave përshtatet MAR-i sipas formulave të paracaktuara. Fillimisht çdo Vit Relevant do të jetë 1 vit.
CPI	Indeksi i Çmimeve të Konsumit
OSSH	Operatori i Sistemit të Shpërndarjes
Rregulla për Çmimet e OSSH-së	Rregulla për Çmimet e OSSH-së
Konsumator i Kualifikuar	Konsumatori që ka të drejtë të zgjedhë furnizuesin e dyte dhe i cili mund të furnizohet nga FPEE-ja apo ndonjë furnizues tjetër. Deri më 31 dhjetor 2014, këta konsumator përfshijnë të gjithë konsumatorët që nuk janë konsumatorë shtëpiak dhe pas kësaj date, kjo kategori përfshin të gjithë konsumatorët (siç përcaktohet në Ligjin për Energjinë Elektrike)
ZRRE	Zyra e Rregullatorit për Energji
Rregulla për Çmimet e Gjenerimit	Rregulla për Çmimet e Gjeneratorëve të Rregulluar
LSA	Marrëveshja për Furnizim me Thëngjill
MAR	Të Hyrat Maksimale të Lejuara
Konsumator i pakualifikuar	Konsumatorët që nuk mund të zgjedhin furnizuesin e dyte dhe të cilët furnizohen nga FPEE. Kjo kategori përfshin konsumatorët shtëpiak deri në vitin 31 dhjetor 2014 (siç përcaktohet në Ligjin për Energjinë Elektrike)
Shqyrtim Periodik	Shqyrtimi dhe ricaktimi i MAR-it dhe parametrave të tjerë para fillimit të Periudhës Rregullative
FPEE	Furnizuesi Publik i Energjisë Elektrike (bartësi i Licencës për Furnizim Publik)
Rregulla për çmimet e FPEE-së	Rregulla për Çmimet e FPEE-së
MBE	Marrëveshje për Blerje të Energjisë
Rregullat për Çmime	Termi i përbashkët për Rregullën për Çmimet e Gjenerimit, Rregullën për Çmimet e OST-së, Rregullën për Çmimet e OSSH-së dhe Rregullën për Çmimet e FPEE-së
RAB	Baza e Aseteve të Rregulluara
Konsumatorë të Rregulluar	Konsumatorët e pa-kualifikuar dhe, në rastet kur nuk ka konkurrencë efektive, konsumatorët të cilët furnizohen nga FPEE-ja me Tarifë të Rregulluar me Pakicë, të përcaktuar nga ZRRE-ja në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë
Gjeneratorë të Rregulluar	Gjeneratorët e definuar sipas Nenit 7 të Ligjit për Energjinë Elektrike, të cilët janë të obliguar të furnizojnë FPEE-në me tarifë të rregulluar
Përshtatje e Rregullt	Ricaktimi i MAR-it në pajtim me formulat e paracaktuara, para çdo Viti Relevant
Periudhë Rregullative	Periudha në mes të Shqyrtimeve Periodike gjatë të cilës MAR azhurnohet sipas formulave të paracaktuara
OST	Operatori i Sistemit të Transmisionit

Dokumenti Sqarues

Rregulla për çmimet e OST-së	Rregulla për çmimet e OST-së
Konsumatorë të parregulluar	Të gjithë ata konsumatorë që nuk janë të rregulluar
WACC	Mesatarja e Ponderuar e Kostos së Kapitalit
WPC	Kostoja e Energjisë me Shumicë

1 Hyrje

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) është në procesin e rishikimit të legjislacionit sekondar që rregullon tarifat dhe ngarkesat e sektorit të energjisë elektrike (të cilave do t'u referohemi kolektivisht si "Rregullat për Çmime") për të qenë në përputhje me Ligjet e amandamentuara për Energji, Energji Elektrike dhe Rregullator të Energjisë, të dekretuara në nëntor 2010.

Ky Dokument ofron një përmbledhje të këtyre Rregullave dhe publikohet së bashku me Rregullat për Konsultim me Publikun.

2 Rregullat për Tarifa

Sipas Ligjit për Energji dhe Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, ZRRE është përgjegjëse për:

- Rregullimin e tarifave në Marrëveshje të Blerjes së Energjisë (MBE) në mes të Gjeneratorëve të Rregulluar dhe Furnizuesit Publik të Energjisë Elektrike në rastet kur konkurrenca për furnizim me shumicë nuk është efektive. Gjeneratorët e Rregulluar janë gjeneratorët e definuar në Nenin 7 të Ligjit për Energjinë Elektrike¹.
- Aprovimin e Metodologjisë Tarifore dhe tarifave dhe ngarkesave të propozuara nga Operatori i Sistemit të Transmisionit² (OST) dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH).
- Përcaktimin e tarifave të rregulluara për furnizim me energji elektrike ndaj konsumatorëve të pakualifikuar dhe, për rastet kur nuk ekziston konkurrencë efektive në furnizim, për konsumatorët e kualifikuar (të cilëve do t'u referohemi si "Konsumatorë të Rregulluar")³.

Për këtë arsye, ZRRE lëshon dokumentet në vijim:

- Rregullën për vënien e çmimeve të Gjenerimit ("Rregullën për Gjenerim")

Kjo Rregull përcakton mënyrën e përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë nga Gjeneratori i Rregulluar ndaj FPEE-së dhe procesin për përcaktimin e këtij çmimi.

¹ Gjeneratorët me kapacitet të instaluar mbi 5MW dhe që janë në operim në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit e të cilët i shesin energji elektrike FPEE-së. Këta përfshijnë Kosovën A, Kosovën B, HEC Ujmani dhe HEC Lumbardhi.

² Për qëllim të këtij Dokumenti, OST përfshin pronarin dhe operatorin e sistemit të transmisionit dhe operatorin e tregut të energjisë elektrike me shumicë.

³ Kriteria të ndara janë lëshuar nga rregullatori për vlerësimin e ekzistencës së konkurrencës efektive në furnizim.

- Rregulla për vënien e çmimeve të Operatorit të Sistemit të Transmisionit (“Rregulla për OST-në”)

Kjo Rregull përcakton të hyrat e lejuara që duhet të mbulohen nga ngarkesat e transmisionit.

- Rregulla për vënien e çmimeve të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (“Rregulla për OSSH-në”)

Kjo Rregull përcakton të hyrat e lejuara që duhet të mbulohen nga ngarkesat e shpërndarjes.

- Rregulla për vënien e çmimeve të Furnizuesit Publik të Energjisë Elektrike (“Rregulla për Çmimet e FPEE-së”)

Kjo Rregull përcakton kostot e lejuara direkte të FPEE-së që duhen mbuluar nga tarifat e rregulluara, kostot që barten (duke përfshirë kostot e blerje së energjisë me shumicë dhe ngarkesat e OST-së e OSSH-së) te tarifat me pakicë, parimet për strukturën e tarifës së rregulluar me pakicë si dhe procesin e përcaktimit të kostove të lejuara të FPEE-së dhe tarifave të rregulluara me pakicë.

3 Rregulla e Çmimeve të OST-së

3.1 Mënyra e rregullimit të çmimit

Vënia e çmimeve do të ndjekë parimin e rregullimit me anë të të Hyrave Tavan të caktuara periudha rregullative 5-vjeçare. Vlera fillestare e kostove të lejuara do të përcaktohet para çdo periudhe rregullative.

Një shembull i thjeshtuar i mënyrës së funksionimit të rregullës është dhënë në aneksin e këtij dokument.

3.2 Përcaktimi i të Hyrave të Lejuara fillestare

3.2.1 Qasja

Të Hyrat Maksimale të Lejuara për OST-në për vitin e parë të Periudhës Rregullative përcaktohen si shuma e shpenzimeve operative, zhvlerësimit mbi asetet e OST-së të përfshira në Bazën e Aseteve të Rregulluara (RAB) kthimin e lejuar në RAB dhe koston e lejuar të blerjes së humbjeve:

- Niveli efikas i shpenzimeve operative do të përcaktohet nga ZRRE gjatë shqyrtimit periodik.
- RAB-i do të përcaktohet siç sqarohet më poshtë.

- Zhvlerësimi në RAB do të bëhet në mënyrë lineare duke përdorur jetëgjatësinë ekonomike⁴ të aseteve.
- Kthimi i lejuar do të llogaritet si prodhimi në mes të Mesatares së Ponderuar të Kostos së Kapitalit (WACC) dhe shumës së aseteve të financuara komercialist të cilat janë të futura në RAB. Asetet e financuara nga grantet kapitale nuk do të kenë kthim të lejuar.
- WACC do të llogaritet duke marrë parasysh koston e ekuitetit të kompanive të krahasueshme komerciale (siç përcaktohet nga ZRRE) dhe koston aktuale të financimit të borxhit⁵, të peshuara sipas gearing-ut (normën e borxhit ndaj ekuitetit) që përcaktohet nga ZRRE.
- Humbjet e lejuara do të përcaktohen duke përdorur cakun e humbjeve të përcaktuar nga ZRRE. Ky cak do të marrë parasysh nivelin e humbjeve për periudhën më të afërt 12 mujore, reduktimet në humbje që mund të vijnë si pasojë e Planit Investiv të OST-së si dhe nivelin e humbjeve në transmision në entitete të krahasueshme.
- OST-ja do të përfitojë një përqindje (që fillimisht pritet të caktohet në 50%) të vlerës së reduktimit të humbjeve nëse kostoja aktuale e humbjeve zbrit nën Cakun e humbjeve. Pjesa e mbetur i kthehet konsumatorëve. Në të njëjtën mënyrë, nëse kostoja e realizuar e humbjeve është mbi cakun e caktuar, ndryshimi do të ndahet në mes të konsumatorëve të OST-së.

3.2.2 Përcaktimi i Bazës së Rregulluar të Aseteve (RAB)

Vlera fillestare e RAB-it që përdoret për llogaritjen e vlerës fillestare të MAR për çdo periudhë rregullative caktohet si vlera hapëse në fillim të Periudhës Rregullative, të cilës i shtohen investimet e aprovuara gjatë periudhës së kaluar rregullative dhe të cilës i zbritet zhvlerësimi dhe shitjet e aseteve gjatë shqyrtimit të kaluar periodik. Të gjitha këto indeksohen për të marrë parasysh Indeksën e Çmimeve të Konsumit (CPI) gjatë kësaj periudhe.

Marrja parasysh e inflacionit ka për qëllim të mbajë vlerën e aseteve të OST-së konstante në terma reale. Ky është indikator i kostos së zëvendësimit të këtyre aseteve, për shkak se rivlerësimi i aseteve gjatë çdo periudhe rregullative do të ishte tejet e kushtueshme, do të mund të merrte kohë të gjatë dhe do të paraqiste risk të lartë rregullator për OST-në (duke marrë parasysh ndikimin e mundshëm si

⁴ Jetëgjatësia ekonomike e aseteve nënkupton jetëgjatësinë teknike të aseteve, përveç në rastet kur asetit pritet të jetë në shërbim për periudhë më të shkurtër se jetëgjatësia teknike (për shembull në rastet kur asetit ndërtohet për një konsumator të caktuar i cili do ta përdorë për vetëm 10 vite). Jetëgjatësia teknike e aseteve është më e gjatë se jetëgjatësia që përdoret momentalisht në llogaritë financiare të të licencuarve.

⁵ Në këtë rast përdoret kostoja aktuale e borxhit për shkak se OST-ja pritet të ketë një shumë të konsiderueshme të “kredive të buta”.

dhe masën e madhe të diskrecionit që mund të kishin këto vlerësime). Meqë vlera e RAB-it do të mbahet konstant në terma reale, WACC-u po ashtu do të përcaktohet në terma reale.

Si pjesë e Shqyrtimit Periodik OST-ja do të dorëzojë, për të marrë aprovimin e ZRRE-së, listën e projekteve investive. Kjo listë e projekteve do të bazohet në Planin Zhvillimor të Transmisionit i cili aprovohet nga ZRRE-ja dhe do të jetë e radhitur sipas prioriteteve dhe do të tregojnë koston dhe përfitimin nga secili projekt. Projektet e aprovuara do të implementohen gjatë Periudhës Rregullative.

Kur një projekt investiv i shtohet RAB-it për shqyrtimin e ardhshëm periodik, ZRRE do të përdorë vlerën e aprovuar e këtij investimi dhe jo vlera e realizuar. Kjo ofron nxitje për OST-në të gjejë mënyrë t'i reduktojë kostot e investimeve. Evidenca mbi koston e realizuar do të përdoret nga ZRRE-ja për aprovimin e kostove investive në të ardhmen.

OST-ja mund të zëvendësojë projekte alternative më të kushtueshme për ndonjë projekt të para-aprovuar nga ZRRE-ja, nëse projekti alternativ ofron përfitime më të mëdha për konsumatorët. Në këto raste OST-ja mund të kërkojë aprovimin paraprak të Rregullatorit. Nëse projekti aprovohet nga Rregullatori, projekto do të përfshihet në RAB-in fillestar të Periudhës së ardhshme Rregullative me koston e aprovuar. Të Hyrat Maksimale të Lejuara për vitin në të cilën kërkohet aprovimi nuk do të ndryshojnë.

Asetet që i përkasin periudhës para vitit 2006, të cilat momentalisht kanë vlerën zero për qëllime rregullative, do të futen në RAB me vlerë pozitive për të marrë parasysh që disa prej tyre janë të përdorura dhe të përdorueshme. Asetet e tjera, të cilat janë ndërtuar në mes të vitit 2006 dhe Periudhës së parë Rregullative, do të përfshihen si të tilla në vlerën fillestare të RAB-it më 1 prill 2012 (viti i parë për të cilën do të vlejë rregulla e re e çmimeve). ZRRE do të konsultohet ndaras për vlerësimin e saktë të këtyre aseteve.

3.3 Përshtatjet e Rregullta

MAR-i fillestar do të ndahet në 3 pjesë:

- Një pjesë që është fikse.
- Një pjesë që varet nga kërkesa maksimale në sistem (shprehur në MW).
- Një pjesë që varet nga vëllimi i energjisë së transportuar (shprehur në MWh).

Në fillim të çdo Viti Relevant, brenda Periudhës Rregullative, MAR-i do të azhurnohet si më poshtë:

- Secila komponentë e MAR do të shumëzohet me ndryshimin e aplikueshëm në Indeksin e Çmimeve të Konsumit (CPI) dhe kësaj do t'i zbritet X-faktori (përshtatje e CPI-X)
- Komponentat e MAR që kanë të bëjnë me kërkesën maksimale në sistem dhe me energjinë e transportuar do të azhurnohen për të marrë parasysh ndryshimet në këto parametra.

Për më tepër, MAR do të përshtatet me vëllimin e transportuar. Ndryshimi në mes të të hyrave të realizuara dhe atyre të lejuara do të merret parasysh në MAR. Kjo korrigjon ndryshimet në të hyra që mund të vijnë si pasojë e ndryshimeve në vëllimet e shitura.

X-faktori dhe vlera fillestare e MAR do të caktohen së bashku për të barazuar Vlerën e Tanishme të kostove të lejuara me Vlerën e Tanishme të të Hyrave të Lejuara gjatë periudhës së kontrollit të Çmimit. Kjo i mundëson ZRRE-së që të nivelizojë ngritjen e tarifave në kohë në mënyrë që të shmangen rritjet e menjëhershme të të Hyrave dhe ngarkesave. Aneksi i këtij dokumenti e sqaron këtë llogaritje.

Përshtatjet e jashtëzakonshme në të Hyrat e Lejuara mund të ndodhin nëse kostot ndryshojnë për arsye që janë jashtë kontrollit të të licencuarit (për shembull kur ndryshojnë ligjet apo taksat). Në rast të këtyre ndryshimeve, kostoja duhet ta kalojë të ashtuquajturin “prag të materialitetit”. Në rastet kur këto kosto e kalojnë këtë prag, ZRRE-ja do t’i përshtatë të Hyrat e Lejuara për të marrë parasysh këtë kompensim. Përshtatja do të marrë parasysh vetëm ndryshimin në kosto si pasojë e rastit në fjalë dhe nuk do të ndryshojë pjesë të tjera të të Hyrave të Lejuara.

3.4 Ngarkesat për shfrytëzim të sistemit dhe për kyçje në sistem

OST është përgjegjës për të zhvilluar metodologjinë për shfrytëzimin e sistemit dhe metodologjinë për kyçje në sistem, të cilat aprovohen nga ZRRE. Rregulla e çmimeve të OST-së kërkon që këto metodologji ta ndjekin Deklaratën e Parimeve që lëshohet nga ZRRE-ja. Këto parime pritet të përfshijnë çështjet si kyçjet e “thella” apo të “cekëta”⁶, nëse duhet të lejohet ndryshimi i tarifave në bazë të vendosjes gjeografike dhe nëse ngarkesat duhet të jenë të bazuara në kërkesë, në kapacitet të kontraktuar, në energji apo duhet të jenë kombinim i këtyre. ZRRE do të ketë një konsultim të veçantë për këtë Deklaratë të Parimeve.

Ngarkesat do të përcaktohen nga OST-ja çdo vit, në pajtim me metodologjinë e aprovuar, dhe do të jenë në nivel që lejojnë mbulimin e Të Hyrave Maksimale të Lejuara brenda vitit.

3.5 Procedurat

Shqyrtimet Periodike do të përfshijnë përcaktimin e vlerës fillestare të MAR dhe X-faktorin që do të përdoret për periudhën e ardhshme rregullative. OST-ja fillimisht do të dorëzojë në ZRRE propozimin preliminar për të hyrat e lejuara për periudhën e ardhshme rregullative. Pas konsultimeve me OST-në, ZRRE-ja do të publikojë një vendim të përkohshëm. ZRRE do të identifikojë dhe arsyetojë të gjitha ato çështje ku Vendimi i përkohshëm ndryshon nga propozimi i OST-së. Vendimi i përkohshëm do t’i

⁶ Ngarkesa për kyçje të thellë nënkupton rrethanat kur përdoruesi paguan kostone kyçjes direkte në rrjet si dhe koston e përforcimit të nevojshëm në rrjetin ekzistues (investime e “thella”). Ngarkesa për kyçje të cekët nënkupton rrethanat kur përdoruesi paguan vetëm koston e kyçjes direkte në sistem.

nënshtrohet procesit të konsultimit publik. Në fund të këtij konsultimi, ZRRE do të marrë vendimin përfundimtar.

Procesi i shqyrtimit periodik do të fillojë së paku gjashtë muaj para fillimit të shqyrtimit të ardhshëm periodik. Vendimi i përkohshëm i ZRRE-së do të publikohet së paku 50 Ditë Pune para fillimit të periudhës së ardhshme rregullative dhe vendimi final do të merret së paku 20 ditë pune para fillimit të periudhës së ardhshme rregullative.

OST-ja mund të paraqesë ankesë në ZRRE lidhur me vendimin e ZRRE-së, duke respektuar legjislacionin relevant. Sipas Nenit 44 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, çdo ankesë duhet të bëhet më herët se 2 muaj pas marrjes së vendimit të ZRRE-së. OST-ja po ashtu mund të paraqesë ankesë në gjykatë.

Përshtatja e rregullt duhet të jetë proces mekanik që nuk i nënshtrohet diskrecionit të rregullatorit dhe, për këtë arsye, nuk i nënshtrohet konsultimit publik.

4 Rregulla e Çmimeve të OSSH-së

Rregulla për Çmimet e OSSH-së ndjek të njëjtën metodologji me atë të çmimeve të OST-së me një përjashtim të vetëm:

- Përveç indeksimit në kërkesën e pikut dhe në njësitë e shpërndara, MAR-i indeksohet edhe për ndryshimin në numrin e konsumatorëve si një prej indikatorëve në kostot e OSSH-së.

OSSH do të ketë nxitjen për reduktimin e humbjeve ku ndryshimet në mes të caktuar të humbjeve, të caktuar nga ZRRE-ja, dhe nivelit të realizuar të humbjeve do të ndahen.

OSSH po ashtu do t'i nënshtrohet një periudhe tranzitore, duke marrë parasysh faktin se transaksioni i paraparë i KEDS-it do të rezultojë në pronar të ri të cilit do t'i nevojitet kohë të kuptojë rrethanat e ndërmarrjes dhe të përgatisë propozimin për shqyrtimin e plotë të tarifave. Periudha e parë rregullative do të zgjasë 1 vit (prej 1 prill 2012 deri më 31 mars 2013). Pas kësaj do të fillojë periudha e dytë rregullative që do të zgjatë 5 vite sikur që do të zgjasin të gjitha periudhat rregullative vijuese.

5 Rregulla e çmimeve të gjenerimit

Rregulla e çmimeve të gjenerimit do të ndjekë të njëjtën Metodologji me Rregullën e Çmimeve të OST-së, përveç ndryshimeve në vijim:

- Kostot e lejuara për Kosovën A dhe Kosovën B do të përfshijnë kostot e minierave, përderisa këto kompani janë në të njëjtën pronësi. Kurdo që hyn në fuqi marrëveshja për furnizim me thëngjill (LSA) në mes të MineCo dhe KEK-ut/GenCos, do të merret parasysh çmimi që është i dhënë në atë marrëveshje.

- Çmimi i rregulluar do të ketë çmimin për kapacitet që përdoret për të mbuluar kostot fikse (shprehur në €/MW) dhe çmimin për energji (shprehur në €/MWh) që përdoret për mbulimin e kostove variabile. Pjesa dërmuese e këtyre kostove për Kosovën A dhe Kosovën B pritet të jetë fikse, pasi që kostot e kapitalit të këtyre gjeneratorëve dhe të kompanisë së minierave supozohet se janë fikse në krahasim me prodhimin e energjisë elektrike dhe thëngjillit. Kjo mund të ndryshojë pas aplikimit të LSA-së për të reflektuar strukturën e çmimit në atë LSA. Për HEC-et Ujmani dhe Lumbardhi, shumica e kostove po ashtu janë fikse për shkak se kostot variabile janë efektisht zero.
- Provizionet për humbjet e lejuara nuk janë të aplikueshme për Gjeneratorët e Rregulluar.

Kostoja e Gjeneratorit të Rregulluar pritet të jetë më e ulët se kostoja e furnizuesve alternativ me shumicë, duke përfshirë këtu edhe importin. Kjo gjendje i jep përparësi të konsiderueshme FPEE-së në krahasim me furnizuesit e tjerë nëse FPEE është furnizuesi i vetëm që ka qasje në prodhimin e këtyre gjeneratorëve. Për të shmangur këtë çrregullim të konkurrencës në tregun me pakicë, ZRRE synon të kërkojë nga FPEE-ja që një pjesë të prodhimit nga Gjeneratorët e Rregulluar ta vëjë në dispozicion për furnizuesit e tjerë (përmes skemave të vënies në dispozicion të kapacitetit, që parashihen në Nenin 25 të Ligjit për Energjinë Elektrike).

Kjo do të duhej të reflektohej në Rregullat për Çmime por një Rregull e veçantë do të draftohet për të udhëzuar se si do të funksionojnë këto skema të vënies në dispozicion të kapacitetit. ZRRE do të konsultohet me publikun për këtë çështje dhe për mekanizmat e tjerë potencial, për t'u dhënë mundësi konsumatorëve të përfitojnë nga kostoja e ulët e Gjeneratorëve të Rregulluar, duke mos çrregulluar konkurrencën në tregun me pakicë.

Periudha fillestare rregullative për Gjeneratorët e Rregulluar propozohet të jetë 4 vite. Periudha e dytë rregullative, që do të fillojë më 1 prill 2016 do të zgjasë 5 vite, ashtu siç do të zgjasin periudhat vijuese rregullative. Kjo është bërë me qëllim të radhitjes së shqyrtimeve periodike në atë mënyrë që shmangin dy shqyrtime në të njëjtin vit (shqyrtime të ndara për OST-në, OSSH-në, FPEE-në dhe Gjeneratorët e Rregulluar) për të mundësuar menaxhimin më të mirë të kohës për të licencuarit dhe për ZRRE-në.

6 Rregulla për çmimet e FPEE-së

6.1 Mënyra e rregullimit të çmimit

Vënia e çmimeve do të ndjekë parimin e rregullimit me anë të të Hyrave Tavan të caktuara periudha rregullative 5-vjeçare. Fillimisht do të ketë dy periudha tranzitore prej 1 viti dhe 2 vitesh, respektivisht, para implementimit të periudhave 5 vjeçare. Kjo do t'i mundësojë pronarit të ri të KEDS të përgatitet për shqyrtimin periodik dhe do të mundësojë përshtatjet e nevojshme të qasjes rregullative para fillimit të hyrjes në funksion të provizionit për konsumatorë të privilegjuar në vitin

2015. Vlera fillestare e kostove të lejuara do të përcaktohet para çdo periudhe rregullative apo gjatë shqyrtimit periodik.

6.2 Përcaktimi i kostove të lejuara

Kostot e lejuara të FPEE-së përcaktohen si shuma e kostove direkte me pakicë, kostove të blerjes së energjisë me shumicë dhe kostove që barten.

6.2.1 *Kostot direkte me pakicë*

Kostot direkte me pakicë janë shuma e shpenzimeve operative të FPEE-së (ku nuk përfshihet kostoja e blerjes së energjisë me shumicë dhe kostoja e OST-së dhe OSSH-së), zhvlerësimi i aseteve të FPEE-së të përfshira në RAB, marzhën me pakicë dhe lejesën për borxhin e keq:

- Niveli efikas i shpenzimeve operative do të përcaktohet nga ZRRE-ja gjatë shqyrtimeve periodike.
- RAB-i dhe jetëgjatësia e aseteve të përdorura për zhvlerësim do të përcaktohet në mënyrë të ngjashme me ato të OST-së dhe OSSH-së.
- Lejesa për Borxhin e Keq do të përcaktohet në nivel të arsyeshëm (pritet të jetë 2-3%). Ndryshimet në mes të nivelit aktual dhe nivelit të lejuar do të barten nga FPEE-ja.
- FPEE-ja do të përfitojë marzhën me pakicë, për t'u kompensuar për riskun, për t'i lejuar kthimin në kapitalin e investuar në biznes dhe për të mbuluar koston e kapitalit punues.

6.2.2 *Kostoja e blerjes së energjisë me shumicë*

Kostoja e blerjes së energjisë me shumicë, që duhet të mbulohet nga FPEE-ja, do të përcaktohet nga ZRRE-ja varësisht nga çmimet e lejuara të Gjeneratorit të Rregulluar, kostot e parashikuara të blerjes së energjisë nga gjeneratorët e tjerë dhe nga importi, kostot e balancimit⁷ dhe përbërjen e parashikuar të furnizimit me shumicë.

Blerjet nga Gjeneratorët me Çertifikata të Origjinës⁸ supozohen të bëhen me çmim që është i barabartë me mesataren e blerjes së energjisë nga burimet e tjera, për shkak se diferenca në mes të kostos aktuale të blerjes nga këta gjeneratorë dhe koston mesatare të blerjes së energjisë mbulohet nga një ngarkesë e veçantë.

⁷ ZRRE gëzon të drejtën që, në të ardhmen, të implementojë mekanizma për të nxitur FPEE-në të reduktojë koston e balancimit, nëse konsideron se kjo kosto mund të kontrollohet nga FPEE.

⁸ Gjeneratorët me tarifa të aprovuara Feed-in për shitjen e burimeve të ripërtërishme të energjisë.

Kapaciteti i kontraktuar nga Gjeneratorët e Rregulluar që i tejkalon kërkesat e FPEE-së dhe çdo kapacitet tjetër i kontraktuar nga FPEE-ja për të përmbushur obligimet për sigurim të furnizimit, që poashtu i tejkalon këto kërkesa, do të vihet në dispozicion për furnizuesit e tjerë në pajtim me skemat për vënien në dispozicion të kapacitetit që do të lëshohen nga ZRRE.

Kur FPEE ka kontraktuar kapacitet nga Gjeneratorët e Rregulluar apo nga gjeneratorët e tjerë për të mbuluar obligimet për sigurim të furnizimit, por ka vënë në dispozicion një pjesë të këtij kapaciteti për furnizuesit e tjerë, FPEE do të lejohet të mbulojë ndryshimin në mes të pagesave të marra nga furnizuesit e tjerë për këtë kapacitet dhe pagesat që janë bërë nga FPEE për gjeneratorët. Ky mekanizëm për mbulim të kësaj diference do të vendoset më vonë nga ZRRE-ja.

6.2.3 Kostot që barten

Kostot që barten (pass-through) të OST-së dhe OSSH-së do të caktohen do të barazohen me MAR-in e këtyre entiteteve siç përcaktohen në çdo vit.

6.2.4 Alokimi i kostove të lejuara

Kostot e lejuara direkte do të alokohen në mes të konsumatorëve të rregulluar dhe të parregulluar të FPEE-së bazuar në numrin e konsumatorëve të tyre. Këto ponderime do të reflektojnë koston direkte të FPEE-së në ofrimin e shërbimeve të faturimit ndaj konsumatorëve individual të kategorive të ndryshme (për shembull kostoja e menaxhimit të faturimit të një konsumatori të madh industrial mund të jetë më e madhe se kostoja e menaxhimit të faturimit për një konsumator të vogël shtëpiak).

Kostot që barten, të blerjes së energjisë me shumicë, do të alokohen në mes të konsumatorëve në atë mënyrë që nuk e çrregullon konkurrencën. Mekanizmi i saktë nuk është definuar ende por pritet të reflektojë pjesëmarrjen e secilës kategori të konsumatorëve në konsumin e gjithmbarshëm ku kjo do të ponderohet varësisht prej koston margjinale të energjisë në çdo periudhë rregullative (ashtu që një pjesë më e madhe e kostove me shumicë do t'i alokohet konsumatorëve të cilët kryesisht konsumojnë në kohën e pikut).

Përfundimi i vetëm i kësaj që u tha më lartë është se, para datës 1 janar 2015, kostoja e importit të blerë nga KEK-u, që merr parasysh subvencionet e qeverisë, do t'u alokohet fillimisht konsumatorëve të pakualifikuar. Kostoja e blerjes së energjisë me shumicë që i tejkalon këto kosto do t'i alokohet konsumatorëve të tjerë të pakualifikuar dhe konsumatorëve të kualifikuar.

Kostot që barten të OST-së dhe OSSH-së do të alokohen në mes të kategorive të konsumatorëve në pajtim me strukturën e koston të OST-së dhe OSSH-së.

6.3 Të hyrat nga eksporti

FPEE-ja inkurajohet të eksportojë energjinë për të cilën ka nënshkruar kontrata kapaciteti dhe e cila është e tepërt për nevojat e menjëhershme. FPEE-ja mund të mbajë një pjesë (që fillimisht pritet të

jetë 50%) të ndryshimit në mes të çmimit të fituar nga këto eksporte dhe kostos së blerjes së energjisë së eksportuar. Ndryshimi do të zbritet nga kostot e lejuara.

Për t'u siguruar se kjo nuk është në konflikt me obligimet e FPEE-së për të furnizuar, do të aplikohet një ndalesë për të eksportuar në kohën kur ka mungesë të kërkesës ndaj konsumatorëve të FPEE-së. Për më tepër, nëse FPEE eksporton në kohën kur ka shkyçje të energjisë elektrike për shkak të mungesës së kapaciteteve gjeneruese atëherë FPEE do të ballafaqohet me ndëshkimin për eksport për tërë vëllimin e eksportuar. Ky ndëshkim do të caktohet në nivel mbi koston e importit në mënyrë që të dekurajohet eksporti i tillë.

6.4 Përshtatjet e rregullta

Vlera fillestare e kostove të lejuara do të azhurnohet brenda çdo viti gjatë periudhës rregullative si vijon:

- Kostot direkte me pakicë – të indeksuara për të marrë parasysh inflacionin dhe X-faktorin.
- Kostot e blerjes së energjisë me shumicë – Çmimet e Gjeneratorëve të Rregulluar do të ricaktohen për t'u barazuar me MAR-in e këtyre entiteteve në vitin që vjen. Çmimet e tjera do të indeksohen për të marrë parasysh koston e blerjes së energjisë me shumicë (për shembull çmimet në European Energy Exchange⁹). ZRRE gëzon të drejtën të ofrojë mënyra alternative të vendosjes së këtyre çmimeve kurdo që konsideron se çmimet e indeksuara nuk e reflektojnë koston e arsyeshme të çmimeve të tregut me shumicë në vitin që vjen.
- Kostot e OST-së dhe OSSH-së do të ricaktohen për t'u barazuar me MAR-in e këtyre entiteteve në vitin që vjen.

Përveç këtyre, do të realizohen edhe këto përshtatje:

- Përshtatja për vëllim – ndryshimi në mes të Të Hyrave të Realizuara dhe atyre të lejuara do të merret parasysh në MAR. Ky korigjim do të marrë parasysh ndryshimet në vëllimet e shitura.
- Përshtatja për koston e blerjes së energjisë me shumicë – Përshtatja në MAR do të marrë parasysh ndryshimin në mes të nivelit të lejuar të koston së blerjes së energjisë me shumicë dhe nivelit të realizuar të kësaj kostoje. Kjo do të sigurojë FPEE-në të mbulojë plotësisht koston e realizuar të blerjes së energjisë me shumicë (përveç marzhës për energji me shumicë – shih më poshtë), me vonesë prej 1 viti. Të Hyrat nga taksa për energjinë e ripërtërishme do të përjashtohen.

⁹ Mundwsuar nga www.eex.com.

- Përshtatja për bartjen e kostos së OST-së dhe OSSH-së – MAR-i do të përshtatet për të marrë parasysh ndryshimin në mes të nivelit të lejuar të kostos së OST-së dhe OSSH-së dhe nivelit të realizuar të kësaj kostoje. Kjo siguron që FPEE-ja të mbulojë plotësisht këto kosto.

Marzha për Energjinë me Shumicë do t'i shtohet MAR-it për ta nxitur FPEE-në të prokurojë energji elektrike në mënyrë ekonomikisht të favorshme dhe të menaxhojë në mënyrë efikase portfolion e tyre në mes të kontratave të gjenerimit dhe të importit. Marzha llogaritet si përqindje e ndryshimit në mes të kostove të realizuara të blerjes së energjisë për dy vite të njëpasnjëshme. Nëse kostot e realizuara të blerjes së energjisë tregojnë rënie, atëherë marzha është pozitive dhe MAR rritet. Anasjelltas, nëse kostoja e blerjes së energjisë rritet, atëherë Marzha është negative dhe MAR zvogëlohet. Në këtë mënyrë, FPEE-ja përfiton nëse zvogëlon kostot e blerjes së energjisë. Niveli i ndikimit të kësaj kostoje, megjithatë, do të jetë i vogël për të mos cenuar mirëqenien financiare të FPEE-së. Kjo mund të arrihet duke caktuar një përqindje në nivel të ulët (për shembull 5%).

Përshtatjet e rregullta janë procedura mekanike për të cilat nuk ka hapësirë për diskrecion rregullator.

Provizionet për shqyrtimet e jashtëzakonshme jepen si për OST-në ashtu edhe për FPEE-në.

6.5 Tarifat e rregulluara me pakicë

Tarifat e Rregulluara me pakicë do të caktohen në nivel që mundësojnë mbulimin e pjesës së kostove të lejuara që u alokohet konsumatorëve që furnizohen me tarifa të rregulluara. Tarifat për secilën kategori të konsumatorëve do të bazohen në kostot e shërbimit ndaj secilës kategorie të konsumatorëve dhe do të marrin parasysh koston margjinale të energjisë me shumicë, koston e kapacitetit dhe koston e furnizimit gjatë periudhave të ndryshme kohore. Ndërsubvencionimet do të ndërpriten deri më 31 dhjetor 2014.

ZRRE do të vlerësojë efektivitetin e mekanizmave të tanishëm për mbrojtjen e konsumatorëve në nevojë. Bazuar në këtë vlerësim ZRRE do të vendosë për nevojën e ndërsubvencionimeve potenciale brenda kategorisë së konsumatorëve shtëpiak.

6.6 Procedurat

Procedurat e shqyrtimeve periodike do të jenë të njëjta me ato të OST-së.

Aneksi 1: Funkionimi i Rregullave për çmime

Ky Aneks ofron një shembull të thjeshtësuar të funksionimit të rregullave për çmime. Shembulli është i aplikueshëm për OST-në, OSSH-në, Gjeneratorët e Rregulluar dhe kostot direkte me pakicë të FPEE-së. Inputet janë zgjedhur për të thjeshtësuar llogaritjet dhe nuk duhet të konsiderohen se përfaqësojnë vlera të atribueshme ndaj cilitdo të licencuar. Humbjet nuk janë përfshirë në këtë shembull.

Përcaktimi i kostove të lejuara

Shpenzimet operative

Shpenzimet Operative fillimisht supozohen të jenë 20 milionë euro për vitin 5 (vitin e parë të periudhës rregullative) dhe të bien për 2% në vit si pasojë e rritjes së efijencës. Në vitin t+1, shpenzimet operative do të jenë 19.6 milionë (llogaritur si $(20 \text{ milionë euro}) * (1-2\%)$).

RAB-i fillestar

RAB-i fillestar do të jetë RAB-i fillestar në periudhën e kaluar rregullative, i azhurnuar për inflacion, të cilit i shtohen investimet kapitale gjatë periudhës së kaluar rregullative, ku merren parasysh edhe shitjet e aseteve dhe zhvlerësimi gjatë periudhës rregullative.

Për shembull, RAB-i fillestar në vitin t-5 (fillimin e periudhës së kaluar rregullative) ka qenë 75 milionë euro. Jetëgjatësia ekonomike është 25 vite. Shpenzimet e aprovuara kapitale gjatë periudhës së kaluar rregullative kanë qene 40 milionë euro. Inflacioni gjatë periudhës ka qenë 2.8% në vit apo 15% gjatë tërë periudhës pesë vjeçare deri në vitin t.

Vlera fillestare e RAB në periudhën rregullative, duke filluar me vitin t, llogaritet si vijon:

Tabela 1: RAB-i fillestar

		miliona €
RAB-i fillestar në vitin t-5		75
Zhvlerësimi	<i>1/25p.v. për 5 vite</i>	-15
Investimet e aprovuara		40
RAB-i fillestar në vitin t, me çmime të t-5		100
Inflacioni (prej vitit t-5 deri në t)	<i>2.8% p.v. per 5 vite</i>	1.2
RAB-i fillestar në vitin t, me çmime të t-5		120

Shpenzimet Kapitale

Shpenzimet kapitale që përfshihen në kostot e lejuara aprovohen nga ZRRE-ja bazuar në planin investiv të dorëzuar nga i licencuari. Për thjeshtësim, supozojmë se shpenzimet e aprovuara kapitale

Rregulla për çmimet e FPEE-së

kanë qenë 25 milion euro dhe se projektet rezultuese hyjnë në punë në vitin që realizohen. Supozojmë po ashtu se të gjitha investimet kapitale financohen përmes huave dhe keshit të brendshëm pa grante kapitale, në mënyrë që RAB dhe RABf të jenë të barabarta.

Zhvlerësimi

Zhvlerësimi llogaritet në mënyrë lineare duke supozuar jetëgjatësi ekonomike prej 25 vitesh për të gjitha asetet.

WACC-u

WACC-u llogaritet duke përdorur koston e vlerësuar të ekuitetit prej 12%, koston e supozuar aktuale të financimit nga huat prej 5%, normën e tatimit mbi korporata prej 10% dhe gearing prej 50%. Llogaritja tregohet më poshtë:

Tabela 2: Llogaritja e WACC

Kostoja e ekuitetit pas taksave (reale)	re	12.0%
Norma e tatimit mbi korporata	t	10.0%
Kostoja e ekuitetit para taksave	$re / (1 - t)$	13.3%
Kostoja e realizuar e borxhit (reale)	rd	7.5%
Gearing	g	0.50
WACC = $g * rd + (1 - g) * [re / (1 - t)]$		10.4%

Kostot e lejuara

Kostot e lejuara përcaktohen çdo vit të periudhës rregullative si shuma e shpenzimeve operative, zhvlerësimit dhe kthimit të lejuar (llogaritur si prodhimi i WACC-ut me RAB-in mesatar), siç tregohet më poshtë.

Rregulla për çmimet e FPEE-së

Tabela 3: Llogaritja e kostos së lejuar

Të gjitha vlerat në miliona €	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5
Shpenzimet Operative	20.0	19.6	19.2	18.8	18.4
Faktori i efqiencies -2.0%					
Baza e Aseteve të Rregulluara (RAB)					
Vlera fillestare	120.0	140.2	159.6	178.2	196.1
Zhvlerësimi	-4.8	-5.6	-6.4	-7.1	-7.8
Shtesat	25.0	25.0	25.0	25.0	25.0
Vlera perfundimtare	140.2	159.6	178.2	196.1	213.2
Jetegjatesia (vite) 25					
Kthimi i Lejuar					
WACC 10.4%	13.6	15.6	17.6	19.5	21.3
Kostoja e Lejuar	38.4	40.8	43.2	45.4	47.6

Konvertimi në të hyra të lejuara

Gjatë periudhës së rregullimit të çmimit, vlera e tanishme e të hyrave të lejuara (të diskontuara sipas WACC-ut) duhet të jenë të barabarta me vlerën e tanishme të kostos. Mirëpo, nuk është e nevojshme që këto të dyja të jenë të barabarta brenda 1 viti të caktuar. Kjo i mundëson rregullatorit t'i përshtatë të Hyrat (rrjedhimisht tarifat) në atë mënyrë që shmangin rritjen e menjëhershme të tyre.

ZRRE do të përcaktojë 'rugën' e të hyrave të lejuara duke caktuar nivelin fillestar të MAR dhe x-faktorin e përdorur për të përshtatur vlerën reale të MAR në çdo vit (duke përdorur formulën $MAR_t = MAR_{t-1} * (1 + CPI - X)$). Si shembull, supozojmë se ZRRE dëshiron të caktojë MAR-in fillestar në nivel prej 35 milion euro (me fjalë të tjera, nën nivelin e kostove të lejuara për vitin e parë relevant). ZRRE mund të llogarisë X-faktorin e nevojshëm në mënyrë që vlera e tanishme e kostove të lejuara dhe vlera e tanishme e të hyrave të lejuara të jenë të barabarta gjatë periudhës rregullative (që në këtë rast është -10.9% - me fjalë të tjera të hyrat e lejuara do të rriten për 10.9% në terma reale). Kjo llogaritje është dhënë më poshtë.

Tabela 4: Llogaritja e MAR dhe X-faktorit

Të gjitha vlerat në miliona €		Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Gjithsej
Faktori diskontues		1.000	0.906	0.820	0.743	0.673	
Kostot e lejuara	Te padiskontuara	38.4	40.8	43.2	45.4	47.6	
	Vlera e tanishme	38.4	37.0	35.4	33.8	32.0	176.5
MAR	Te padiskontuara	35.0	38.8	43.0	47.7	52.9	
	Vlera e tanishme	35.0	35.2	35.3	35.5	35.6	176.5
X-faktori		-10.9%					

Përshtatjet e Rregullta

Përshtatjet e rregullta nënkuptojnë rritjen e MAR nga viti paraprak për të marrë parasysh ndryshimin në kostot e ndryshme, inflacionin dhe X-faktorin. Për shembull, supozojmë se kostot të cilat ndikojnë në MAR janë piku i shërbyer (D, matur në MW) dhe njësitë e transportuara (E, matur në MWh). Ponderimi i këtyre supozohet të jetë si vijon:

Faktori fiks (a) = 0.5

Faktori që ka të bëjë me kërkesën e pikut (b) = 0.25

Faktori që ka të bëjë me energjinë e transportuar (c) = 0.25

Në vitin t (vitin e tanishëm) dhe t-1 (vitin e kaluar) këto vlera kanë qenë si vijon:

	Viti t	Viti t-1	Ndryshimi
Energjia e Pikut (MW)	500	525	+5%
Energjia e transportuar (MWh)	2,000	2,200	+10%

Llogaritja e MAR, në këto raste, bëhet si vijon:

Rregulla për çmimet e FPEE-së

Tabela 5: Llogaritja e përshtatjes së Rregullt

		miliona €
$A_t = a * M_{ARt-1} * (1 + CPI_t - X)$	$= 0.5 * 35 * (1 + 2.5\% + 10.9\%)$	19.8
$B_t = b * M_{ARt-1} * (1 + CPI_t - X)$	$= 0.25 * 35 * (1 + 2.5\% + 10.9\%)$	9.9
$C_t = c * M_{ARt-1} * (1 + CPI_t - X)$	$= 0.25 * 35 * (1 + 2.5\% + 10.9\%)$	9.9
$M_{ARt} = A_t + B_t * (D_t/D_{t-1}) + C_t * (E_t/E_{t-1})$	$= 19.8 + 9.9 * (525 / 500) + 9.9 * (2200 / 2000)$	41.2